



KUSHTET PËR ABONIM NË SHËRBIMET E TELEVISIONIT DIGJITAL PËR BIZNESE TË OFRUARA NGA IPKO TELECOMMUNICATIONS LLC

Neni 1 - Përmbajtja e Kushteve të abonimit

1.1 Kushtet për abonim në Shërbimet IPKO's, përkatësisht shërbimet e shërbimit të televizionit digjital për biznes (në tekstin e mëtejme referuar si "**Kushtet**"), udhëheqin të drejtat, obligimet dhe kushtet për shfrytëzimin e këtij shërbimi të ofruar nga "IPKO Telecommunications sh.p.k (në tekstin e mëtejme referuar si "**IPKO**)",

1.2 Pos këtyre Kushteve, mënyra dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve të Televizionit Digjital për biznes do të udhëhiqen gjithashtu nga Ligji për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109, nga rregulloret e aplikueshme për ofrimin e shërbimit të telekomunikimeve elektronike në Kosovë, të miratuara nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë (në tekstin e mëtejme referuar si "**ARKEP**"); nga Kontrata për abonim në Shërbimet e IPKO's, përkatësisht shërbimet e Televizionit Digjital për biznes, oferta, shtojcat përkatëse, çmimet e publikuara nga IPKO's, si edhe dokumentet e tjera të nënshkruara nga Përdoruesi dhe IPKO, të cilat, në tërësi përbëjnë Marrëveshjen ndërmjet tyre.

Neni 2 - Definicionet

"**Shërbimet e Telekomunikimit**" janë një linjë shërbimesh janë në linjë me shërbimet e pakapshme duke përfshi këtu internetin, telefoninë fikse, telefoninë mobile dhe Televizionin Digjital, si dhe produktet e prekshme duke përfshi receptor telefonik dhe pajisjet shtesë.

"**IPKO Telecommunications LLC**" është një entitet legal që pajis me Shërbime të Telekomunikimit Përdoruesit e vet në territorin e Kosovës.

"**Palë/ët**" është një individ dhe /ose entitet ligjor që përbën një palë në këtë marrëveshje.

"**Përfaqësues i Autorizuar**" është individ që ka të drejtë ligjore të veprj dhe/ose nënshkruaj Kontratën në emër të Palës në Marrëveshje.

"**Dokumentacioni Plotësues**" është Kontrata, Kushtet e të Produktit, Lista e Çmimeve, Anekset.

"**Kontrata**" është dokumenti i cili nënshkruhet nga palët, që e bëjnë Marrëveshjen të jetë e lidhur në mënyrë ligjshme.

"**Marrëveshja**" Marrëveshje nënkupton tërë marrëdhënien kontraktuese ndërmjet Përdoruesit dhe IPKO-s për të përdorur shërbimin e televizionit digjital për bizneset.

"**Kushtet e Abonimit të Produkteve**" është dokumenti ku janë të përshkruara karakteristikat e veçanta të produkteve dhe shërbimeve.

"**Anekset**" është dokumentacioni shtesë që përdoret si mbështetje e Kushteve Specifike të Produkteve për të mbledhur informacion për Përdoruesin gjithashtu edhe për të mundësuar Përdoruesit që të t'i mundësohet shërbimi apo e kundërta. "Lista e Çmimeve" është lista e çmimeve dhe tarifave që shoqëron çdo produkt dhe shërbim të dhënë nga IPKO.

"**Mbështetja e Përdoruesit (Customer Support)**" është informacioni, ndihmesa (troubleshooting) dhe këshilla që i ipet Përdoruesit nga IPKO.

"Data e hyrjes në fuqi" është data/koha në të cilën Kontrata është nënshkruar.

"**Aktivizimi/Data e lëshimit të shërbimit**" është koha nga e cila Përdoruesi ka qasje dhe mund të përdor shërbimin dhe produktin e përzgjedhur.

"**Pezullim**" është gjendja në të cilën Përdoruesi nuk ka qasje në shërbime përkohësisht, përveç nëse shërbimet dhe produktet e përzgjedhura nga Përdoruesi janë anuluar.

"**Anulimi/Terminimi**" është gjendja në të cilën të gjitha shërbimet në të cilat Përdoruesi ka pasur qasje janë anuluar dhe nuk mund të përdoren pa ri – abonim.

"**Përdoruesi i Shërbimeve**" është personi fizik apo ligjor i cili është i abonuar në një apo më shume produkte dhe shërbime të ofruara nga IPKO, dhe i cili në mënyrë direkte apo indirekte, pranon Kushtet e Përdorimit të IPKO's.

"**Rrjeti**" është hapësira ku lidhen pajisjet, pa ose me tel, që bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit.

“Pajisjet” janë instrumente të nevojshme për ndërmarrjen ose kryerjen e shërbimit. Ato mundësojnë kryerjen e detyrave me anë të përparësive mekanike, ose ofron mundësinë që nuk do të ishte e mundshme t’i ofrohej në mënyrë natyrore Përdoruesit të shërbimit.

“Modeli i Aprovuar i Pajisjeve” është pajisja që është në pajtueshmëri me standarde të caktuara.

“Voice Modemi” është pajisje në të cilën lidhet aparati telefonik i Përdoruesit, pa të cilën nuk mund të arrihet qasja në shërbimin e Telefonisë fikse të IPKO’s.

“Modemi” – është pajisje që mundëson lidhjen e kompjuterëve me rrjetin e IPKO’s dhe nga aty e drejton lidhjen në internet.

“Marrësi Digjital /Set-top Box është pajisje ku futet kartela Smart dhe e cila lidhet me televizorin dhe me burim të jashtëm të sinjalit, i cili shndërron sinjalin digjital në përmbajtje, i cili pastaj paraqitet në televizor.

“Kartela Smart (Smart Card)” është Kartelë që futet në marrësin digjital dhe pa të cilën nuk mund të hapen paketat me kanale televizive.

Neni 3 – Çasja në Shërbimin e Ofruar

3.1 Në mënyrë që të ketë qasje në shërbimet e televizionit digjital për biznese, Përdoruesi është i detyruar të lidh kontratë me IPKO-n. Për kontratë, ai / ajo duhet të paraqesë në IPKO dokumentet ne vijim: Certifikatën e biznesit; Informacion mbi Biznesin, me afat vlefshmërie prej më së paku 12 muaj; Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar për të lidhur Marrëveshjen; Në rast se personi i autorizuar nuk është pronari i biznesit, autorizimin origjinal për të njëjtin.

3.2 IPKO është i detyruar të sigurojë për përdoruesit ekzistues të shërbimeve të internetit për biznese, ose telefoni fikse, shërbimet e televizionit digjital për bizneset, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune, nga dita kur Përdoruesi nënshkruan kontratën për të përdorur televizionin digjital.

3.3 Konsumatorët e ri që nuk janë të abonuar në shërbimin e internetit ose telefoninë fikse të IPKO-s dhe që dëshirojnë të përdorin shërbimin në fjalë, shërbimi do të ofrohet pas përfundimit të instalimit të nevojshëm, më së voni brenda dhjetë (10) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Obligimet e IPKO’s

Neni 4 - Cilësia e shërbimit

4.1 IPKO do t’i ofrojë Përdoruesit shërbim të cilësisë së lartë, në mirëbesim dhe në pajtueshmëri me mundësitë teknike dhe kushtet e pajtuara.

4.2 IPKO rregullisht do të monitoroj dhe bëj matje të shfrytëzimit të kapaciteteve të rrjetit, dhe, në segmente specifike, në mënyrë dinamike do të evitoj ngarkesat eventuale. Për segmentet ku nuk ka mundësi të realizohet mënyra dinamike e shpërndarjes së ngarkesës, IPKO do të aplikoj procedura të brendshme për optimizim të burimeve në këto segmente. Aplikimi i këtyre mënyrave dhe procedurave të brendshme nga IPKO do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e kualitetit të shërbimit. Niveli më i ulët i kualitetit të shërbimit të ofruar për konsumatorë bazohet në vlerat që publikohen nga matjet e bëra nga ARKEP.

4.3 Duke njoftuar paraprakisht Përdoruesin, IPKO rezervon të drejtën të ndërpresë ofrimin e shërbimit për arsye të mirëmbajtjes, avancimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Këto ndërprerje mund të zgjasin për aq kohë sa do të zgjasë kryerja e punëve.

4.4 IPKO do të bëjë riparimin e pengesave duke u referuar në kushtet dhe nivelin e shërbimeve të raportuara nga matjet e bëra nga ARKEP, duke mos i përjashtuar edhe shërbimet e asistencës;

4.5 Në pajtim me këto Kushte, IPKO nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë ndërprerje, ose dobësim të shërbimit të Televizionit Digjital HD, apo për ndonjë defekt në rrjet, i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, apo nga ndonjë rrethanë jashtë kontrollit të IPKO’s, të cilën nuk mund ta parashikojë dhe parandalojë (forca madhore). Në rast të defekteve të mëdha në rrjete, IPKO do t’i ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për riparim sa më të shpejt të këtyre defekteve, duke e respektuar listën prioritare të nenit 16.1 të Rregullores Nr. Prot. 009/B/16 të ARKEP.

4.6 Në asnjë rast, IPKO nuk do të mbajë përgjegjësi për dëmet indirekte, apo humbje të të ardhurash, shkaktuar Përdoruesit.

4.7 Asnjë siguri, apo garanci nuk mund të jepet lidhur me disponueshmërinë, cilësinë, funksionimin, apo mirëmbajtjen e trafikut të zërit, apo të të dhënave në rastet kur Përdoruesi komunikon me individë që përdorin një operator tjetër telekomunikues.

Neni 5 - Zgjidhja e ankesave të Përdoruesve dhe kujdesi ndaj tyre

5.1 Ne pajtim me këto Kushte, IPKO do të ofroj mbështetje Përdoruesit me anë të telefonit shtatë (7) ditë në javë njëzet e katër (24) orë në ditë në numrat e telefonit +386 (0) 49 700 700 dhe +381 (0) 38 700 700. Çmimet për thirrje në numrat për kujdesin ndaj konsumatorëve janë pa pagesë vetëm për thirrjet brenda rrjetit të IPKO-së (on-net) ndërsa për thirrjet nga operatorët lokal (PTK, Vala dhe Zmobile) aplikohen tarifat e përcaktuara nga këta operatorë. Gjithashtu IPKO i ofron mbështetje Përdoruesit edhe përmes numrit 080070070 pa pagesë, nga të gjithë përdoruesit e operatorëve në Kosovë.

5.2 Pas njoftimit të defektit, në rast se i njëjti nuk mund të eliminohet nëpërmjet telefonit, IPKO brenda 5 (pesë) ditëve do t'i kthej përgjigje Përdoruesit për zgjidhjen e problemit.

5.3 Përdoruesi duhet të paraqet kërkesë për kompensim në afat prej 30 ditëve nga dita e njoftimit/paraqitjes së problemit.

5.4 Në rast të ndërprerjes së shërbimeve për së paku një (1) ditë, atëherë IPKO për çdo ditë do të kompensojë dy (2) ditë përdoruesin fundor. Kompensimi mund të bëhet në formë të rimbursimit ose duke zgjatur validitetin varësisht nga lloji i shërbimit ose i pakos.

Neni 6 – Obligimet e Përdoruesit

6.1 Përdoruesi është i obliguar të përdorë shërbimet e Televizionit Digjital HD për biznese, në pajtim të plotë me marrëveshjen në fjalë.

6.2 Përdoruesit i ndalohet keqpërdorimi i shërbimit, gjegjësisht, Përdoruesi është i obliguar të përdor shërbimet në përputhje me Marrëveshjen dhe ligjet në fuqi, përndryshe IPKO ka të drejtë të bashkëpunoj me organet kompetente të ligjit dhe, varësisht nga shkalla e keqpërdorimit IPKO ka të drejtë të marrë këto masa:

- i. T'ia tërheqë vërejtjen Përdoruesit që të shfrytëzojë shërbimin në pajtueshmëri me Marrëveshjen;
- ii. Të pezulloj apo anulojë automatikisht shërbimin e dhënë nga IPKO, pa kurrfarë përgjegjësie për kompensim ndaj Përdoruesit dhe si rezultat të kërkojë kompensim dëmsh të pësuar nga keqpërdorimi, bërë nga Përdoruesi.

6.3 Në rast se IPKO e anulon kontratën me Përdoruesin për arsye të cekura më sipër, ky i fundit është përgjegjës t'i kryejë të gjitha obligimet financiare të mbetura ndaj IPKO's.

6.4 Përdoruesi nuk lejohet të përdor ose lejoj përdorimin e Shërbimeve, që do të shkaktojnë mosfunksionimin e rregullt të rrjetit ose kualitetin e Shërbimeve, dobësimin apo ndërprerjen apo ndërhyrjen në integritetin ose sigurinë e cילו rrjet apo sistem të telekomunikimit.

6.5 Përdoruesi pajtohet me instruksionet ose kërkesat e IPKO's dhe/ose autoritetit të autorizuar, posaçërisht mënyrës së përdorimit të shërbimit dhe në lidhje me hetimin e ndonjë kundërvajtjeje.

6.6 Përdoruesi nuk lejohet të rishes asnjë produkt ose shërbim të dhënë nga IPKO përveç në raste kur ka pajtim me shkrim me marrëveshje të ndarë me IPKO' n. Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të IPKO's është qartazi i limituar për Përdoruesin, emri i të cilit paraqitet në Kontratë. Përfitimet, të drejtat dhe obligimet të pranuar me këtë marrëveshje nga Përdoruesi nuk mund të transferohen tek pala e tretë pa miratim me shkrim nga IPKO.

6.7 Përdoruesi është i obliguar të paguaj të gjitha pagesat dhe detyrimet në përputhje me Marrëveshjen.

6.8 Përdoruesi duhet menjëherë të lajmëroj IPKO' n në lidhje me problemet eventuale me shërbimet ose produktet që është duke i përdorur.

6.9 Përdoruesi duhet të ofroj shënime personale të sakta kur ato kërkohen nga IPKO. Për çdo ndryshim të këtyre informacioneve Përdoruesi duhet ta njoftoj IPKO-n brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e ndryshimit.

Neni 7 – Pajisjet e IPKO's dhe facilitetet e rrjetes:

7.1 Marrësit digjital dhe kartela smart janë pronë e IPKO-s.

7.2 Garancia për marrësit digjital SD është 6 muaj, ndërsa për Smart Card është 4 - vjet, që nga momenti i pranimit. Riparimi i pajisjeve do të bëhet nga kompania e kontraktuar nga IPKO, detajet e kontaktit të së cilës do të ofrohen për Përdoruesin në kohën e nënshkrimit. Gjatë periudhës së garancisë, kompania e kontraktuar është përgjegjëse për çdo riparim të ndonjë defekti që rrjedh nga përdorimi normal i pajisjeve.

7.3 Përdoruesi është i detyruar të përdor dhe mirëmban pajisjet si parashihet nga udhëzimet e prodhuesit të pajisjeve, si dhe ato të dhëna nga IPKO. Për çdo defekt të pajisjeve, të caktuar nga kompania kontraktuese, Përdoruesi është i detyruar të raportojë kompanisë së kontraktuar.

7.4 Përdoruesi është përgjegjës për çdo dhe të gjithë rrjetin elektrik të furnizimit me energji të lidhur me pajisjet që ofron shërbimin. Përdoruesi nuk do ta bëjë IPKO' n përgjegjës për çdo dhe të gjitha defektet dhe / ose dëmet që rezultojnë nga energjia elektrike me te cilën eshët e lidhur pajisja e shërbimit/modemi.

7.5 Për tokëzimi dhe masat mbrojtëse ndaj rrufesë dhe mbitensionit elektrik të pajisjeve dhe instalimeve shtëpiake të klientit (përveç marrësit digjital dhe modemit), janë pjesë e instalimeve dhe pajisjeve shtëpiake të përdoruesit dhe për këto, IPKO Telecommunications LLC nuk mban asnjë përgjegjësi në të gjitha rastet kur ato pajisje dhe instalime nuk janë ekzekutuar/vendosur dhe kyçur sipas normave dhe standardeve rajonale. Të gjitha dëmet eventuale të pajisjeve ose instalimeve të përdoruesit, që mund të shkaktohen ose shkaktohen nga jo korrektësia e këtyre masave mbrojtëse ose mosrespektimi i standardeve dhe normave rajonale, nuk do te kompensohet nga IPKO Telecommunications LLC dhe të gjitha garancionet do të jenë nule. Për sigurinë e përdoruesit dhe të pajisjeve shtëpiake të përdoruesit, rekomandohet që përdoruesi të bëjë përtokëzimin në një pikë të përbashkët të gjitha video dhe audio pajisjeve dhe instalimeve të kyçura në rrjetin e IPKO Telecommunications LLC.

7.6 Në rast se Përdoruesi nuk ndjek rregullat për përdorimin e pajisjeve të përcaktuara në Nenin 7të këtyre kushteve, dhe si rezultat i veprimeve të tij /saj marrësi digjital apo kartela smart nuk janë të përdorshme dhe janë dëmtuar, Përdoruesi duhet të blejë një marrës digjital të ri dhe kartelë smart, çmimi i të cilave është i paracaktuar në listën e çmimeve të IPKO-s. Nëse IPKO konstaton se marrësi digjital, ose kartela smart janë të papërdorshme, Përdoruesi do të pajiset me marrës të njëjtë digjital apo kartelë smart, pa pagesë.

7.7Lista e aktiviteteve parandaluese e propozuar nga IPKO për përdoruesin e saj është si vijon:

7.7.1Në kohë të rrufesë përdoruesin duhet të shkyç pajisjet nga prizat elektrike;

7.7.2Përdoruesi duhet të sigurojë që o tërë rrjeti elektrik në shtëpi ka sistem tokëzimi me standard prej <50hm;

7.7.3Përdoruesi këshillohet të përdorë/instalojë prizat me mbrojtje nga tensioni në mënyrë që të mbrojë amvisërinë nga rrufetë dhe tensioni i lartë elektrik;

7.7.4Përdoruesi këshillohet të përdorë korrektor të tensionit dhe UPS (furnizim i pandërprerë me rrymë) për të mbrojtur amvisërinë nga tensioni i paqëndrueshëm dhe ndërprerjet e rrymës elektrike;

7.7.5Udhëzime për kyçjen e drejtë të pajisjeve të IPKO-s:

- o Hapi 1 Shkyçe TV;
- o Hapi 2 Lidh kabllon RF (lidhësi i radio frekuencës) në IPKO STB;
- o Hapi 3 Lidh kabllot e TV (HDMI – Multimedia Interfejs me Definim të lartë ose RCA fono lidhësin);
- o Hapi 4 Kyç STB (Marrësi digjital) në rrymë;
- o Hapi 5 Hap TV dhe STB;

7.7.6 Udhëzime për shkyçjen e drejtë të pajisjeve të IPKO-s:

- o Hapi 1 Mbyll TV dhe the STB(Marrësi digjital);
- o Hapi 2 Nxjerr kabllon e STB nga rryma;
- o Hapi 3 Nxjerr kabllon IPKO RF (lidhësi i radio frekuencës) nga STB(Marrësi digjital);
- o Hapi 4 Nxjerr kabllon HDMI (HDMI - Multimedia Interfejs me Definim të lartë).

7.8 TVIM është i limituar në rrjetin e IPKO's për shkak të drejtave për transmetim të kontentit.

Neni 8 – Çmimet, tarifat dhe mënyra e pagesës

8.1 Pagesa e shërbimit të ofruar nga IPKO do të bëhet në euro, si monedhë zyrtare në Kosovë.

8.2 Lista e çmimeve të IPKO-s do të përfshijë koston e shërbimeve. Lista e çmimeve mund të ndryshohet.

8.3 Në rast të faturave të diskutueshme, Përdoruesi është i detyruar të paraqesë ankesë me shkrim përfaqësuesit të shitjes për biznese, ose në zyrën e biznesit të IPKO-s.

8.4**Kushtet e pagesës** - Përdoruesi do të pranojë faturën (at) nga IPKO nga data 1 deri në 6 të muajit përkatës, ndërsa Përdoruesi duhet të paguaj faturën më së largu deri në datën 10 të njëjtit muaj. Përdoruesi mund ti paguaj faturat ne dyqanet e IPKO's, ne distributorët e autorizuar apo përmes bankës.

8.5Në rast të mos pagesës së faturës nga ana e Përdoruesit, IPKO do të aplikojë masat e mëposhtme:

- o Njoftim përmes Email-it;
- o Njoftim përmes SMS-it;

- o Thirrje nga IPKO ;
- o De aktivizim/terminim i shërbimit;
- o Dërgimi i lëndës për kompensim të borxhit ndaj IPKO's tek Përmbartuesi privat/ Gjykatë. Në këtë rast, IPKO do të aplikojë kamat-vonesën konform Ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

8.6 Nëse Përdoruesi nuk e respekton afatin për pagesën e faturës (ave), IPKO rezervon të drejtën të pezullojë shërbimin në fjalë. Në rast të pezullimit të shërbimit, Përdoruesi është i detyruar të paguajë çmimin e ri-instalimit të lidhjes së pezulluar, bazuar në çmimet e përcaktuara në kontratë, oferta dhe broshura të IPKO-s.

8.7 Në rast Përdoruesi nuk paguan vlerën e shërbimit të marr na IPKO per dy muaj me radhë, IPKO rezervon të drejtën për të anuluar shërbimin dhe të ndërpres shërbimet, dhe të fillojë procedurën ligjore për kompensimin e borxhit të Përdoruesit ndaj IPKO-s.

8.8 Faturat për shërbimin e ofruar nga IPKO, Përdoruesi do ti pranoj ne tri forma te ndryshme: SMS fature, PDF email fature, selfcare portal.

8.9 Çasje në sistemin selfcare portal bëhet duke ndjekur hapat me poshtë:

- Përdoruesi duhet fillimisht ta nënshkruaj Kontratën për ofrimin e shërbimit;
- Përdoruesi duhet ta dërgoj një kërkesë përmes USSD
- Përdoruesi do ta pranoj një SMS me emrin e Përdoruesit dhe fjalë-kalimin
- Përdoruesi duhet ta krijoj një llogari personale në portalin biznesit (selfcare portal)
- Përdoruesi do ta pranoj një token kod e SMS sa herë që ai / ajo do të kërkojë për të lidhur në portalin biznesit(selfcare portal) .
- Në këtë portal Përdoruesi do të ketë qasje ne të gjitha fatura edhe për muajt e mëparshëm.

8.9 Në rast se përdoruesi vendos që të ndërpresë përdorimin e shërbimit para skadimit të afatit të pakos, atëherë çfarëdo mbetjeje në llogarinë e tij do të humbasë.

8.10 Në rast se Përdoruesi ka ende ditë të mbetura nga pakoja aktive dhe dëshiron që të aktivizojë një pako tjetër (që dallon nga pakoja e tashme aktive), atëherë Përdoruesi humb ditët e mbetura dhe ka të aktivizuar menjëherë pakon e dëshiruar.

8.11 Në rast se Përdoruesi dëshiron të rimbushë pakon para skadimit të afatit të llogarisë, atëherë atij nuk i humbin ditët e mbetura, por vetëm i shtohet validiteti i pakos për aq ditë sa ka afat llogaria e re, nga dita e skadimit të llogarisë së vjetër.

8.12 Tarifat e IPKO's, çmimet për kyçje, depozitat garantuese dhe modalitetet e aplikacioneve do të përfshihen në formën me shkrim në Dokumentacioni Plotësues dhe/ose në dispozicion në www.ipko.com.

8.13 Përveç në raste kur merret ndryshe në Dokumentacionin Plotësues, IPKO do të faturoj pagesat në euro dhe Përdoruesi do të mund të kryej detyrimet në euro. Në çmime është e përfshirë Tatimi në Vlerën e Shtuar (TVSH), përveç për autoritetet e liruara në bazë të ligjeve në fuqi të Kosovës.

8.14 Në rast të pagesës së vonuar nga Përdoruesi shkalla e interesit dhe/ose tarifa e pagesës së vonuar do të aplikohet në Listën e Çmimeve.

8.15 Të gjitha çmimet janë në shumë neto. Detyrimet shtesë, provizioni bankar, përveç detyrimeve normale për pagesa brenda vendit duhen të paguhen nga Përdoruesi.

Neni 9 – Të drejtat e autorit

9.1 Të gjitha programet që transmetohen në rrjetin digjital të IPKO-s janë të mbrojtura me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejta të ndërlidhura (Nr. 2004/45), si dhe ligjet e tjera përkatëse të aplikueshme në Kosovë.

9.2 Riprodhimi, ri-publikimi, ruajtja, ritransmetimi, ose rishpërndarja e ndonjë prej programeve të transmetuara në televizionin digjital të IPKO-s është rreptësisht e ndaluar, përveç për përdorim personal.

Neni 10 - Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe ndërprerja e marrëveshjes ndërmjet Përdorueseve dhe IPKO-s

10.1 Marrëveshja për shërbimet e Televizionit Digjital HD do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të kontratës nga Përdoruesi, dhe lidhet për një periudhë prej se paku 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi edhe për vitet e tjera, sipas kushteve të njëjta.

10.2 IPKO dhe Përdoruesi rezervojnë të drejtën për ndërprerjen e marrëveshjes para skadimit të kontratës së detyrueshme, me njoftim paraprak me shkrim prej 1 muaj, me kusht që Përdoruesi ka kryer të gjitha detyrimet financiare ndaj IPKO's para njoftimit për shkëputje.

10.3 Në rastet kur Përdoruesi ka nënshkruar Kontrate në afat kohor prej 24 muaj, dhe dëshiron ta ndërpresë kontratën para skadimit të afatit kontraktues atëherë Përdoruesi është i detyruar të kompensojë IPKO-n në vlerën e investimeve të ofrimit të këtij shërbimi, rrjedhimisht vlerën e muajve të mbetur të përcaktuar në Kontratën kryesore, përkatësisht në Kontratën për ofrimin e shërbimit të Televizionit Digjital.

10.4 Në çdo rast të ndërprerjes të kësaj Marrëveshjeje, qoftë nga Përdoruesi ose nga IPKO, Përdoruesi është i detyruar të paguajë të gjitha borxhet e mbetura të IPKO-s, brenda afateve të përcaktuara nga IPKO, në të kundërtën, IPKO do të fillojë procedurat ligjore për kompensimin e dëmeve që i janë shkaktuar IPKO-s nga veprimet e Përdoruesit.

10.5 IPKO rezervon të drejtën e ndërprerjes së shërbimit në rast të shkeljes nga Përdoruesi të këtyre Kushteve të Veçanta. Në rast të shkeljeve të rënda, IPKO ruan të drejtën të marrë masa ligjore kundër Përdoruesit sipas Ligjeve në fuqi.

10.6 Përdoruesi do të informohet me kohë për të gjitha ndryshimet e propozuara në kushtet e Marrëveshjes jo më vonë se tridhjetë(30) para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve. Në rast të mospajimit të ndryshimit të kushteve të Marrëveshjes, Përdoruesi ka të drejtë të shkëpusë Kontratën, pa u ndëshkuar.

10.7 Përdoruesi ka të drejtë të shkëpusë Marrëveshjen në rast se IPKO do të rrisë tarifën për shërbimin e përcaktuar me Marrëveshje, pa u ndëshkuar deri në ditën e fundit të muajit pas pranimit të faturës së parë si rezultat i këtyre ndryshimeve.

10.8 Përdoruesi mund të shkëpusë kontratën, me paralajmërimin me shkrim dhe pa përmendur arsyet për këtë. Marrëveshja do të shkëputet në kohën e zgjedhur nga përdoruesi, edhe nëse kërkon shkëputje të menjëhershme. IPKO do të ndërpresë shërbimin sa më shpejt që teknikisht është e mundur dhe do të konfirmojë këtë me shkrim tek përdoruesi.

10.9 Në rast të ndërprerjes së marrëveshjes, qoftë nga Përdoruesi apo nga IPKO, Përdoruesi është i detyruar të kthejë pajisjet SD që ai / ajo ka marrë nga IPKO me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes. Pajisja e dorëzuar (marrësit digjital dhe kartela smart) duhet të jetë në gjendje të mirë.

Neni 11 - Pezullimi dhe anulimi i shërbimeve

11.1 IPKO mundet, me njoftim paraprak, të pezullojë Shërbimet Përdoruesit në tërësi ose pjesërisht në rast se Përdoruesi dështon të kryejë detyrimet në afat të çfarëdo shume ndaj IPKO-s me anë të kësaj Marrëveshjeje në datën e caktuar të specifikuar në faturë, ose në rast të kryerjes së ndonjë aktiviteti mashtrues ndaj produkteve dhe shërbimeve të IPKO's.

11.2 IPKO mund, pa njoftim paraprak, të anulojë Shërbimet Përdoruesit për ndonjë arsye të bazuar, duke përfshirë, pa limitim:

- i. kur Përdoruesi nuk përmbush obligimet që dalin nga Marrëveshja (dhe veçanërisht Obligimet e Përdoruesit të përcaktuara në këtë dokument) ose ndonjë ligji.
- ii. Përdoruesi i ofron IPKO's informata të falsifikuara, të pasakta ose mashtruese ose nuk e njofton IPKO'n për ndonjë ndryshim që ngjan, siç kërkohet në Nenin 6 të këtyre Kushteve.

11.3 Në rast të anulimit, çfarëdo vlere e mbetur në llogarinë e Përdoruesit do të tërhiqet nga IPKO.

Neni 12 - Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's, bashkëpunimi me organe të rendit

12.1 **Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's** . IPKO në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale 03/L-172 përpunon të dhënat personale të përdoruesve të shërbimeve të saj të komunikimeve elektronike, që përfshijnë emër, mbiemër, numër personal, adresë, numër telefoni fiks, numër mobil, adresë email. Përdoruesi mund të informohet në faqen zyrtare të IPKO's www.ipko.com/mbrojtja-e-te-dhenave/ lidhur me procedurat e ruajtjes dhe të përpunimit të të dhënave personale. Përdoruesi gjithashtu mund të paraqesë çfarëdo kërkesë apo ankese me shkrim në lidhje me përdorimin e të dhënave, në email adresën ipkoprivacy@ipko.com.

12.2 **Bashkëpunimi me organe të rendit**. Përdoruesi mban përgjegjësi të plotë për informacionin, apo përmbajtjen e të dhënave, të cilat i transmeton dhe i bartë te personat e tretë nëpërmjet rrjetit të internetit të IPKO's. IPKO nuk mban kurrfarë përgjegjësie për këtë përmbajtje, si edhe as për të dhënat, të cilat Përdoruesi i pranon nga palët e

treta, nëpërmjet rrjetit të IPKO's. Në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë, IPKO do të bashkëpunojë me organe të rendit për kërkesat që këto organe do të kenë lidhur me shërbimin në fjalë që përdor Përdoruesi.

Neni 13 - Bartja e të drejtave dhe obligimeve dhe kufizimi i përgjegjësisë

13.1 Përdoruesi nuk ka të drejtë të bartë të drejtat dhe obligimet që lindin nga kjo Marrëveshje tek palët e treta, pa miratimin paraprak me shkrim të IPKO's.

13.2 IPKO ruan të drejtën të bartë të drejtat dhe obligimet që lindin nga kjo Marrëveshje tek pasuesi ligjor i IPKO's.

13.3 Aq sa është e lejuar me ligj, IPKO nuk është përgjegjës për ndonjë lëndim, humbje ose dëmtim, që rezulton në mënyrë direkte nga përdorimi i shërbimeve apo produkteve të IPKO's nga Përdoruesi ose nga paaftësia e Përdoruesit të përdor shërbimet e IPKO's. IPKO nuk është përgjegjës për ndonjë shërbim apo produkt që është shitur nga ndonjë agjent tregtar i paautorizuar apo palë e trete e paautorizuar.

Neni 14- Forca Madhore: Çështjet përtej kontrollit të arsyeshëm të ndonjërës nga palët

14.1 Asnjëra palë nuk është e përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve të shkaktuara nga ose që rezultojnë nga Forca Madhore që përfshin ngjarjet që janë të paparashikueshme, të papritura, të pa rezistueshme dhe përtej kontrollit të palëve, siç është moti i ashpër dhe ekstrem, përmytje, rrëshqitje dheu, tërmet, stuhi, vetëtimë, zjarr, akte terrorizmi, luftë (me apo pa deklarimin e luftës), trazira, eksplozime, grevë ose protesta të punëtorëve, trazira civile, sabotazh, shpronësim nga ana e qeverisë ose akte tjera apo ndonjë ndodhi që është jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës përkatëse. IPKO nuk është përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve në rast të:

- i. refuzimi apo vonesa nga pala e tretë për furnizimin e IPKO-s me shërbime të telekomunikimit dhe në rast kur nuk ka shërbim alternativ tjetër në dispozicion me çmim të arsyeshëm; ose
- ii. IPKO është i penguar nga kufizimet të natyrës ligjore apo të ARKEP të ofroj shërbimin e caktuar.

Neni 15 – Ligji në fuqi dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

15.1 Kjo marrëveshje do të udhëhiqet dhe interpretohet në pajtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Të gjitha pikat e diskutueshme do të dorëzohen në zyrën e IPKO's. Përgjigja do të ipet brenda 15 ditëve.

15.2 Në rast se Palët nuk arrijnë me anë të bisedimeve të arrijnë marrëveshje, atëherë Përdoruesi mund të iniciojë procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, përfshirë parashtrimin e ankesës në pajtim me procedurat dhe rregullat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, të parapara në nenin 84 të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109.

Neni 16 – Dispozitat përfundimtare

16.1 Marrëveshja në tërësi e përbërë nga këto Kushte të Përdorimit dhe të gjitha dokumente e tjera plotësuese zëvendësojë të gjitha marrëveshjet e mëparshme me gojë apo me shkrim në mes të Përdoruesit dhe IPKO's dhe përbejnë Marrëveshjen në tërësi në lidhje me objektin e saj dhe nuk duhet të ndryshohet ose përmirësohet, përveç se me shkrim dhe nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar nga të dy palët. Në rast se ndonjë dispozitë në Marrëveshje është e paligjshme ose e pa zbatueshme do të ndahet dhe largohet nga Marrëveshja, dispozitat e mbetura do të qëndrojnë në fuqi dhe IPKO do të gjej me kohë zëvendësim.